

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tregjet në panik: Ai dhe nafta 'godasin' bursat globale
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/tregjet-ne-panik-ai-dhe-nafta-godasin-bursat-globale-i586024
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHË


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 12:22:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 13:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	12f204764f5a6e1dcca6ebe25724a56ecc175a23f6be6cab6657884debbe88c9
TEKSTI	c7c671a7ed1d0a13c4dd96a16bf546382712b3e34c7d53e660889f1e80b44b65
PAMJA	34c4e8d18cbd17bd1f783714b21b60871c069289767dabb6be1b1f3dac055942

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	33ac2fb28e2a30e969f6f04ad8d3f9512f6bf8af6c4cce2be1e37e97a51481fe
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0b6439cf09af002acf6ffba878872d12e4fabe601bb852ed9a98adac17b7c4e3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/33ac2fb28e2a30e969f6f04ad8d3f9512f6bf8af6c4cce2be1e37e97a51481fe>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



le Rrugetimi drejt dijes nis me mbështetje. Òne Albania prane 100 femijeve pa kujdes prinderor te F'shatit SOSHBA-ja paralajmëron Serbine per atrimin me Kinen ne tushë fundit

Tregjet në panik: AI dhe nafta 'godasin' bursat globale



14 Shtator 2026, 15:30Bota TEMA



Bursat kryesore aziatike u mbyllën në rënie për shkak të shqetësimeve në rritje për inteligjencën artificiale (AI), të cilat goditën veçanërisht kompanitë e teknologjisë. Ndërkohë, çmimi i naftës vazhdon të rritet.

Në Tokio, Nikkei ra me 0.8%.

Në Seul, Kospi ra me 3.35%.

Kompania SoftBank ra rreth 11%, pasi Sam Altman deklaroi se OpenAI nuk planifikon të dalë në bursë këtë vit.

Shqetësimet për AI u shtuan pasi drejtuesi i Anthropic, Dario Amodei, kërkoi që të ngadalësohet zhvillimi i modeleve të avancuara të AI-së. Sam Altman i OpenAI e mbështeti këtë ide.

Edhe bursat europiane hapen në rënie

Bursat europiane nisën ditën kryesisht me humbje. Përfashtim bëri Londra, e cila në minutat e para u rrit me 0.53%.

Ndërkohë:

– Parisi: -0.58%

– Frankfurt: -0.27%

– Milano: -0.5%

Në tregje po ndikojnë dy faktorë kryesorë: pasiguria rreth zhvillimit të AI-së dhe rritja e fortë e çmimit të naftës.

Çmimi i naftës është rritur pas mbylljes së një tubacioni të rëndësishëm në Arabinë Saudite dhe sulmeve të reja në Ngushticën e Hormuzit.

Pse situata është shqetësuese për Evropën?

Tensionet në Lindjen e Mesme, sulmet e Houthis dhe dëmtimi i rafinerive ruse po ndikojnë në furnizimin me energji dhe po rrisin kostot për Evropën.

Dy shqetësimet kryesore janë mungesa e mundshme e naftës diesel dhe rritja e kërkesës për gaz natyror, pasi Evropa po përgatitet për dimër me rezerva më të ulëta.

Në të njëjtën kohë, kostot e borxhit të vendeve evropiane po rriten. Franca është nën presion të madh financiar, ndërsa edhe Italia po përballet me një situatë gjithnjë e më të vështirë.

Shqetësimet për AI-n, rritja e çmimit të naftës dhe tensionet gjeopolitike po bashkohen dhe po krijojnë një situatë më të tensionuar në tregje, me rrezik për inflacion të lartë dhe të qëndrueshëm.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Rritja e çmimit të naftës - Trump gjen 'fajin' te Ukraina: Nuk ka ndikuar lufta në Iran

14:00 Bota

Bill Clinton tregon pse CIA i tha të mos e vrisnin Bin Ladenin para 11 Shtatorit

13:50 Bota

Përplasje në BE për sanksionet ndaj Rusisë, Sllovakia kërkon ndryshime

13:40 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.